

Të nderuar kolegë,

Fakti që shumica e deputetëve folën për bujqësinë, do të thotë se rendi i ditës është i tillë, dhe unë kam zgjedhur të flas për bujqësinë. Pak ditë më parë, në Devoll dhe në disa zona të tjera të Korçës rreshjet e dendura të breshrit shkatërruan prodhimet bujqësore. Plantacionet e mollëve u shkatërruan në masën 50%-80%, në disa vende plotësisht. Në të njëjtën mënyrë u dëmtua edhe gruri në fillim të korrikut në shumë fshatra. Dua të komentoj pak debatin që u bë këtu. Për mendimin tim, breshër, shi dhe fatkeqësi natyrore do të ketë gjithmonë, por nuk mund të thuhet se qeveria nuk mban asnjë përgjegjësi, përkundrazi, qeveria duhet të angazhohet që t'i përballojë këto dëme dhe fatkeqësi që vijnë nga natyra dhe jo nga njeriu. Nga ana tjetër, një qeveri nuk mund të subvencionojë çdo dëm natyror, ndaj patjetër që duhet menduar një rrugë tjetër. Bujqësia në vendin tonë është një sektor me rrezik shumë të madh, sepse është e ekspozuar ndaj faktorit natyror dhe shumë faktorëve të tjerë, që e bëjnë këtë sektor shumë të brishtë dhe të ndjeshëm ndaj rreziqeve. Duke qenë kështu, kompanitë e sigurimeve hezitojnë të bëjnë sigurimin e tyre, por, edhe në rastet kur e bëjnë, primi i kërkuar prej tyre është shumë i lartë. Ai shkon midis 3% dhe 8% të vlerës së dëmit të mbuluar. Pra, i bie që për 1 kilogram misër, të paguhet 10 lekë të vjetër, që janë shumë, ose për një pulë vezësh të paguhet rreth 1 euro, që është jashtë mase shumë. Me kosto kaq të larta, fermerët e kanë vështirë të sigurohen vullnetarisht. Pra, ka një rrugë për t'u dalë përballë këtyre fatkeqësive natyrore, që është siguri i prodhimeve bujqësore e blegtorale. Nëse do të ketë subvencionim dhe do të rritet vëmendja ndaj bujqësisë, tregu i sigurimeve është gati të bëhet pjesë e këtyre skemave për të gjetur sigures të leverdishëm. Skema e sigurimit të fermës në Shqipëri është një program që ka për qëllim mbështetjen e fermerëve dhe prodhuesve të kulturave bujqësore, në rast të dëmeve të mundshme nga faktorë të ndryshëm natyrorë, siç janë thatësira, rreshjet e dendura e të tjera.

Kjo skemë duhet të jetë pjesë e politikave të qeverisë shqiptare për të përmirësuar prodhimin bujqësor dhe për të mbrojtur fermerët nga rreziqet. Nëse ndodh një përmytje, thatësi, ngricë e të tjera, dëmi mund të jetë shumë i madh, deri në 100%. E vetmja zgjidhje për të futur fermerët në skemën e sigurimeve do të ishte subvencionimi i primeve nga shteti. Duhet që shteti të financojë primin e sigurimit ose të paktën një pjesë të tij. Një specialist i fushës sugjeron se, nëse do të alokoheshin 5 milionë lekë në vit për subvencionimin e primit në bujqësi, mund të siguroheshin 25 mijë fermerë të formalizuar në vit dhe kjo do të na shërbente edhe për formalizimin e këtij sektori. Bujqësia është një ndër sektorët ku rritja po bëhet me ritme më të ulëta se pjesa tjetër e ekonomisë. Pësia e bujqësisë në prodhimin e brendshëm bruto është në rënie prej katër vjetësh me radhë. Është tentuar që zhvillimi i bujqësisë të nxitet me skema vjetore mbështetjeje, por po të shohim rritjen e sektorit në vitet e fundit, ai nuk ka dhënë rezultate shumë të kënaqshme. Sigurimi mund të ndihmojë rritjen e kreditimit të fermerëve. Sigurimi në bujqësi do të shmangte problemet financiare me të cilat do të përballlej fermeri apo subjekti, në rast se do të humbiste pjesërisht ose totalisht prodhimin e tij. Një fermer i siguar ka garantuar stabilitetin financiar nëpërmjet transferimit të riskut te siguresi. (Bie gongu.) Atëherë, po dal në fund të fjalës sime, pasi ka mbetur shumë pak kohë. Bujqësia ka shumë probleme, por tri çështje të përmendura vazhdimisht janë: - Subvencionet direkte për çdo fermer që merret me bujqësi e blegtori. Në fund të fundit, ky është një problem opinioni, mund ta zgjidhni, mund të mos e zgjidhni, kjo është puna juaj.

- Barazimi në blerje dhe në shitje i TVSH-së së produkteve bujqësore e blegtorale nga grumbulluesit e përpunuesit. Për këtë çështje kam shumë besim se ministrja e re, duke qenë se e ka profesion të saj, do ta shikojë me prioritet.

- Pjesëmarrja e shtetit në skemat e sigurimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, e cila si fillim mund të bëhet edhe në formën e një projekti pilot. Në përfundim, siguria e fermerëve është një mision i përbashkët që kërkon bashkëpunim më gjithëpërfshirës, sidomos nga qeveria.

Faleminderit!